

**BASHKIA TIRANË**  
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për: Operatorin Ekonomik “ERZENI/SH” shpk

Adrese: Shkoder, Lagjja Bahçallek, Rruga Nacionale Shkoder-Tirane, nr pasurie 17/910, zona kadastrale 8591

Procedura e prokurimit: Mobilim me pajisje dhe orendi i objektit “Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 ( Nr.2)” me fond limit 48,312,657 (dyzet e tetë milion e treqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë, në mbështetje të Aktit Normativ Nr.9 datë 16.12.2019 ”Për Përballimin e Pasojave të Fatkeqësisë Natyrore“, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.212, datë 11.03.2020 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të objekteve arsimore, në Bashkinë Tiranë dhe caktimin e Bashkisë Tiranë si Njësi Zbatuese” i ndryshuar, të VKB Nr. 51, datë

06.04.2021 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2021-2023 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2021”(i ndryshuar), Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.225 datë 12.04.2021 “Për një ndryshim në Vendimin Nr.199, datë 04.03.2020, ”Për miratimin e dokumentave standarte të procedurës së prokurimit, kriterëve të vlerësimit të ofertës fituese kushteve të marrëveshjeve kuadër dhe të kontratës për procesin e rindërtimit”, udhëzimit Nr.1 datë 13.02.2020 të Agjensisë së Prokurimit Publik , udhëzimit Nr.1 datë 07.01.2021 të Agjensisë së Prokurimit Publik, në mbështetje në ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 për “Prokurimin Publik”, neni 52 dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik”, (i ndryshuar).

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-96163-05-21-2021.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Mobilim me pajisje dhe orendi i objektit “Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 (Nr.2)” .

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit:

Faza e I-rë: Në sistemin e prokurimeve elektronike dt. 03.06.2021 Ora: 08:30

Faza e II-të: Hapja e propozimeve teknike dhe ekonomike , datë 01.07.2022, ora 12:00

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Posaçëm Nr. 80 datë 24 Maj 2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët □ oferta ekonomikisht më e favorshme X

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomike “M.LEZHA” shpk & “ERALD” shpk
2. Operatori Ekonomik “ERZENI/SH” shpk

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në fazën II në procedurë, këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “ERZENI/SH” shpk NUIS J66902027T

Vlera: 47,684,850 (dyzet e shtatëmilion e gjashtëqind e tetëdhjetë e katërmijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh

Pikë totale: 100 pike

2. Bashkimit të Operatorëve Ekonomike “M.LEZHA” shpk & “ERALD” shpk NUIS J76504013C & J74517205P.

Vlera: 47,941,550 (dyzet e shtatëmilion e nëntëqind e dyzet e njëmijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh

Pikë totale: 99.6 pikë

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

Nuk ka Operatore Ekonomik te skualifikuar.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik “ERZENI/SH” shpk NUIS J66902027T, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 47,684,850 (dyzet e

shtatëmilion e gjashtëqind e tetëdhjetë e katërmijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh dhe pikët totale të marra 100 *pikë* është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Bashkisë së Tiranës*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 13.07.2022

Ankesa: Nuk është paraqitur asnjë ankesë nga Operatorët Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e lartpërmendur të prokurimit.